REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE
MINISTRI

Nr. 41 Prot.

Tiranë, më 06.11.2026

URDHËR

Nr. 1, datë 06.11.2026

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË URDHRIN NR. 334, DATË 7.10.2020, TË MINISTRIT TË DREJTËSISË, "PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË VLERËSIMIT TË RISKUT TË INTEGRITETIT PËR INSTITUCIONET E QEVERISJES QENDRORE"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, shkronja "f", pikës 4, të vendimit nr. 812, datë 28.10.2026, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Administratës Publike", dhe në zbatim të vendimit nr. 859, datë 26.12.2024, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Strategjisë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2024-2030, Planit të Veprimit 2024-2026 në zbatim të saj dhe pasaportës së treguesve të performancës",

URDHËROJ:

1. Në shtojcën nr. 3, "Pyetësori për Institucionin publik të qeverisjes qendrore", të Metodologjisë së Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Institucionet e Qeverisjes Qendrore, miratuar me urdhrin nr. 334, datë 7.10.2020, të ministrit të Drejtësisë, pas pyetjes nr. 53 shtohet seksioni V, "PROKURIMET PUBLIKE", që përmban pyetjet nr. 54 deri në nr. 64, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri dhe pjesë përbërëse e tij.
2. Seksioni i shtuar sipas pikës 1 të këtij urdhri përdoret nga institucionet e qeverisjes qendrore për identifikimin, analizën dhe vlerësimin e risqeve të integritetit në fushën e prokurimit publik, në kuadër të hartimit dhe përditësimit të planeve të integritetit.
3. Ngarkohen institucionet e qeverisjes qendrore dhe strukturat e tyre përgjegjëse për vlerësimin e riskut të integritetit, hartimin dhe përditësimin e planeve të integritetit, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

ADEA PIRDENI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - MINISTRIA E ADMINISTRATËS PUBLIKE - TIRANË